Vendim nr. 267, datë 27.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 27.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (S) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SKËNDER DEMIRAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 1932, datë 11.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 5, 6 dhe 45 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 186, datë 09.07.2020 (*procedimi penal nr. 186/2020*)

për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë", në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*), në ngarkim të kërkuesit dhe shtetasve N.B. dhe K.Zh., në formën e dhënies së përfitimit të paligjshëm, si dhe të veprës penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të KP-së në ngarkim të shtetases M.M., me detyrë gjyqtare dhe bashkëshortit të saj A.C., në formën e marrjes së këtij përfitimi të paligjshëm. Sipas akuzës, kërkuesi, i cili ka ushtruar profesionin e avokatit, i ka dhënë shtetasit A.C. një shumë parash me qëllim që bashkëshortja e tij gjatë ushtrimit të funksionit të saj si gjyqtare të ndryshonte masën e sigurimit për shtetasin O.B. nga "Arresti në burg" në "Garancia pasurore". Këtë vepër, sipas akuzës, kërkuesi e ka kryer në bashkëpunim me shtetasin N.B. (vëllai i O.B.), nga njëra anë, dhe me shtetasin K.Zh., nga ana tjetër.

2. Me vendimin nr. 37, datë 07.02.2021, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO-ja e Shkallës së Parë)* ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit dhe, në përfundim të gjykimit të çështjes, me vendimin nr. 69, datë 15.12.2022 (*vendimi nr. 69/2022),* ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale për të cilën ishte akuzuar dhe e ka dënuar atë me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 261, paragrafi 1, shkronja "b", të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur të tij, duke e vënë kërkuesin në provë për një periudhë kohe prej 3 vjetësh. Po kështu, bazuar në nenit 35 të KP-së, gjykata ka vendosur edhe shuarjen e masës së sigurimit personal që ishte caktuar ndaj kërkuesit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim, ndër të tjerë, kërkuesi.

3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 52, datë 12.12.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të nr. 69/2022 të GJKKO-së së Shkallës së Parë.

4. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1932, datë 11.12.2025, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

5. Në datën 28.04.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Ndërsa në datën 25.06.2026 kërkuesi ka parashtruar argumente shtesë për ankimin kushtetues të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika

2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e:

6.1. Së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të:

6.1.1.Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi dy nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, I.P. dhe A.B., që kanë shqyrtuar rekursin e tij, kanë qenë njëkohësisht edhe pjesë e trupit gjykues të asaj gjykate që me vendimet nr. 00-2021-323, datë 18.05.2021 dhe nr. 00-2021-443, datë 29.06.2021 ka vendosur mospranimin e rekursit. Po kështu, kërkuesi ka ngritur në të gjitha shkallët e gjykimit pretendimin për zëvendësimin e përfaqësueses të të gjykuarit N.B., me arsyetimin se është avokate e asociuar pranë studios ligjore "F." dhe në konflikt interesi, pasi hetimet për këtë çështje duhet të shtriheshin edhe mbi drejtuesin e kësaj studioje, i cili ka dalë në përgjimet e bisedave telefonike si personi që ka marrë përsipër zgjidhjen e çështjes. Megjithatë, kjo kërkesë është rrëzuar me arsyetimin se pretendimi është marrë në analizë, por nuk është provuar të ketë shkelje të nenit 16 të KPP-së, duke krijuar ngatërresë të qëllimshme me nenin 49/b të KPP-së për papajtueshmërinë e mbrojtjes. Ky qëndrim i kundërligjshëm është mbajtur me qëllimin për të mbrojtur personin në fjalë, çështja e të cilit ka kaluar në kompetencë të prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm si rezultat i kësaj marrëveshjeje. Ky qëndrim tregon gjithashtu njëanshmëri të organit të akuzës dhe gjykatave, të cilat punojnë me dy standarde.

6.1.2.Së drejtës për mbrojtje efektive të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi gjykatat e faktit duhet të kishin dhënë arsye të mirargumentuar për refuzimin për të marrë provat e kërkuesit, duke qenë se ato mund të ndikonin në përcaktimin e rrethanave dhe fakteve të çështjes, të cilat janë determinante për identifikimin e elementeve të veprës penale. Gjykatat jo vetëm që nuk kanë kryer një hetim efektiv në funksion të evidentimit nëse kishte falsifikim të vendimit, por nuk i kanë dhënë mundësinë kërkuesit për të realizuar një debat real me akuzën për të zbuluar të vërtetën. Gjykata e Lartë, nga ana e saj, duke mos pranuar rekursin e kërkuesit nuk i ka korrigjuar këto shkelje, pavarësisht natyrës së tyre kushtetuese.

6.1.3.Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë është mjaftuar vetëm me marrjen e pjesëve nga vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta, duke dalë me një vendim alogjik. Ajo gjykatë nuk është ndalur as në faktin se dy gjyqtarë, një në shkallë të parë dhe një në apel, kanë dalë me mendim pakice për sa i takon kualifikimit të veprës. Madje edhe mendimi i pakicës të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë në favor të kërkuesit nuk është arsyetuar mjaftueshëm.

6.1.4.Parimit të proporcionalitetit të dënimit, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi kërkuesi është dënuar më shumë se maksimumi që përcakton dispozita përkatëse. Kjo pasi ai është dënuar për një periudhë 3-vjeçare dhe ndonëse i kishin mbetur për të vuajtur edhe 8 muaj e 24 ditë në paraburgim, gjykata ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit për një periudhë 3-vjeçare, duke urdhëruar mbajtjen e kontakteve me Zyrën e Shërbimit të Provës për 3 vjet, edhe pse neni 59 i KP-së përcakton qartë se për dënime deri në 2 vjet, koha e shërbimit të provës është jo më e madhe se 2-fishi i dënimit për të cilin është vendosur pezullimi i ekzekutimit. Për rrjedhojë, koha e pezullimit nuk mund të ishte më e madhe se 18 muaj.

6.2. Parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi organi procedues duhet të mbledhë jo vetëm prova që provojnë fajësinë e të pandehurit, por edhe prova që shkojnë në favor të tij. Nga përgjimet e bisedave telefonike rezulton se i pandehuri N.B. i ka kërkuar kërkuesit të ndërhyje me të gjitha mënyrat, ndërsa ky i fundit është shprehur "*nuk jam sekseri jot*". Po kështu, nga bisedat telefonike rezulton se kërkuesi ka kërkuar mundësinë të debatojë me një anëtare të trupit gjykues dhe i pandehuri K.Zh. është shprehur se me relatorin "*mbaron punë me 5000 euro*", ndërsa kërkuesi ka deklaruar "*me lekë jo*". Po nga këto biseda rezulton se një avokate (Sh) ka qenë ajo që ka paguar paratë, ndërsa N.B. ka thënë se do të thonë që avokaten e kishte dërguar kërkuesi. Këto elemente nuk janë vlerësuar nga gjykatat, duke u paragjykuar fajësia e kërkuesit në funksion të marrëveshjes së fshehtë të prokurorisë me avokatin P.F.

6.3. Dinjitetit të kërkuesit, pasi gjatë hetimit të kësaj çështjeje kërkuesi vuante nga një sëmundje e pashërueshme dhe i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale, megjithatë gjykatat nuk kanë pranuar të zbusin masën e sigurimit "Arresti në shtëpi" dhe as e kanë lejuar të kryejë një vizitë mjekësore të specializuar jashtë shtetit. Në këto kushte, ato gjykata e kanë trajtuar kërkuesin në mënyrë çnjerëzore, pa analizuar rrezikun real për jetën e tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

7. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "i" të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis,* bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 11.12.2025 dhe i është komunikuar përfaqësueses së kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 09.02.2026, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 28.04.2026, pra brenda afatit 4-mujor.

9. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në disa aspekte (së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, së drejtës për mbrojtje efektive të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe proporcionalitetit të dënimit)*; të parimit të prezumimit të pafajësisë,* të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës; *të dinjitetit të kërkuesit,* sipas neneve 15, 21 dhe 55 të Kushtetutës, si dhe nenit 3 të KEDNJ-së.

10. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, kërkuesi ka argumentuar se dy nga

gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që kanë shqyrtuar rekursin e tij, kanë qenë njëkohësisht edhe pjesë e trupit gjykues të kësaj gjykate, që me vendimet nr. 00-2021-443, datë 29.06.2021 dhe nr. 00-2021-323, datë 18.05.2021 ka vendosur mospranimin e rekursit të të bashkëpandehurës M.M. Po kështu, sipas tij, ai ka ngritur në të gjitha shkallët e gjykimit pretendimin për zëvendësimin e përfaqësueses të të gjykuarit N.B., me arsyetimin se është avokate e asociuar pranë studios ligjore "F." dhe në konflikt interesi, pasi hetimet për këtë çështje duhet të shtriheshin edhe mbi drejtuesin e kësaj studioje, i cili ka dalë në përgjimet e bisedave telefonike si personi që ka marrë përsipër zgjidhjen e çështjes. Megjithatë, kjo kërkesë është rrëzuar me arsyetimin se pretendimi është marrë në analizë, por nuk është provuar të ketë shkelje të nenit 16 të KPP-së, duke krijuar ngatërresë të qëllimshme me nenin 49/b të atij kodi.

11. Për sa më sipër, Kolegji vëren se kërkuesi për të provuar njëanshmërinë e gjykatës në procesin e kundërshtuar ka sjellë dy argumente, vendimmarrjet e Gjykatës së Lartë gjatë hetimeve paraprake në lidhje me të bashkëpandehurën M.M., në të cilat kanë qenë pjesë e trupit gjykues edhe anëtarët A.B. dhe I.P., si dhe mospranimin nga ana e gjykatave të kërkesës së kërkuesit për të zëvendësuar avokaten e njërit prej të bashkëpandehurve, pasi, sipas tij, kishte konflikt interesi.

12. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 7, datë 11.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*. Mënyra sesi disponon gjykata lidhur me çdo kërkesë të palëve gjatë procesit gjyqësor është objekt kontrolli nga gjykatat më të larta dhe nuk përbën shkak njëanshmërie. Marrja e vendimeve nga gjyqtarët dhe administrimi i gjykimit prej trupit gjykues janë shfaqje të çmuarjes dhe vlerësimit që i njihet gjyqtarit në gjykimin e çështjes, si shprehje e pavarësisë dhe paanësisë së tij (*shih vendimin nr. 3, datë 15.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, thjesht fakti që një gjyqtar në një gjykatë penale është përfshirë edhe në vendimet që lidhen me paraburgimin për çështjen, nuk mund të justifikojë në vetvete frikën për paanshmërinë e tij, ajo që ka rëndësi është shkalla dhe natyra e këtyre vendimeve. Kur merr një vendim për paraburgimin dhe vendime të tjera paraprake të këtij lloji, gjyqtari vlerëson menjëherë të dhënat e disponueshme për të përcaktuar nëse ka baza *prima facie*

për dyshimin kundër një të akuzuari për kryerjen e një vepre penale. Ndërsa kur jep vendimin në përfundim të gjykimit ai duhet të vlerësojë nëse provat që janë paraqitur dhe debatuar në gjykatë mjaftojnë për ta shpallur të akuzuarin fajtor. Dyshimi dhe konstatimi formal i fajësisë nuk duhen trajtuar si çështje të njëjta (*shih vendimin nr. 16, datë 17.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë, me trup gjykues të përbërë edhe nga gjyqtarët për të cilët kërkuesi ka pretenduar njëanshmëri, në datat 18.05.2021 dhe 29.06.2021 ka shqyrtuar rekurset e të bashkëpandehurës M.M. ndaj vendimeve të gjykatës së apelit për marrjen në pyetje të saj, me qëllim verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit. Po kështu, i njëjti trup gjykues në datën 11.12.2025 ka dhënë vendimin objekt ankimi kushtetues individual për mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit që e ka deklaruar fajtor dhe dënuar atë për akuzën në fjalë.

15. Pretendimi i kërkuesit për paanshmërinë e dy anëtarëve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është marrë në shqyrtim nga ai kolegj, i cili, në lidhje me të, ka vlerësuar se, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 17, pika 1, shkronja "e", të KPP-së, gjyqtarët I.P. dhe A.B. nuk kanë shkaqe që të heqin dorë nga gjykimi i çështjes, pasi në çështjet e referuara nga kërkuesi nuk kanë ushtruar funksionet e gjyqtarit të hetimeve paraprake ose/dhe seancës paraprake (funksione këto që ushtrohen vetëm nga gjyqtarët e faktit*)*, por funksione rishikuese për shqyrtimin e rekurseve për pretendimet e shkeljes së ligjit material ose procedural. Në ato vendimmarrje gjyqtarët në fjalë nuk kanë bërë vlerësime të tilla të fakteve/provave që të krijojnë qoftë edhe në dukje paragjykim në mënyrë që të plotësohen kushtet e heqjes dorë/përjashtimit sipas neneve 17 dhe 18 të KPP-së, ndaj nuk kanë pengesë për shqyrtimin e rekursit të kërkuesit kundrejt vendimeve të gjykatave të faktit për zgjidhjen e çështjes penale në themel.

16. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë, mbështetur edhe në jurisprudencën kushtetuese të sipërcituar, është i arsyetuar dhe arsyetimi i saj në këtë drejtim nuk duket arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për paanshmërinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë si rrjedhojë e pjesëmarrjes së tyre në shqyrtimin e mëparshëm të rekurseve ndaj masave të sigurimit personal të të bashkëpandehurës, është haptazi i pabazuar.

17. Edhe për sa i takon argumentit tjetër të kërkuesit, se gjykatat nuk kanë pranuar kërkesën e tij për zëvendësimin e avokates së palës tjetër, si argument në drejtim të paanshmërisë së gjykatës në shqyrtimin e çështjes së tij, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë sesi rrëzimi i kësaj kërkese ka ndikuar në dënimin e kërkuesit, duke mos e ngritur këtë argument në nivel

kushtetues. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit, i bazuar edhe në këtë argument, është haptazi i pabazuar.

18. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të proporcionalitetit të dënimit*, kërkuesi ka pretenduar se është dënuar më shumë se maksimumi që përcakton dispozita përkatëse, pasi ai është dënuar për një periudhë 3-vjeçare dhe ndonëse i kishin mbetur për të vuajtur edhe 8 muaj e 24 ditë në paraburgim, gjykata ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit për një periudhë 3-vjeçare, edhe pse neni 59 i KP-së përcakton se për dënime deri në 2 vjet, koha e shërbimit të provës është jo më e madhe se 2-fishi i dënimit për të cilin është vendosur pezullimi i ekzekutimit. Për këto arsye, koha e pezullimit nuk mund të ishte më e madhe se 18 muaj.

19. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe i llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Në këtë drejtim, elementet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 47 të KP-së janë përcaktuese në individualizimin e drejtë të dënimeve penale *(shih vendimet nr. 10, datë 28.02.2024; nr. 9, datë 26.02.2016; nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Po sipas Gjykatës, detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Kolegji vëren se, sipas nenit 47 të KP-së, gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të kodit dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Ndërsa neni 59 i KP-së ka parashikuar se për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte

me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale (pika 1). Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata (pika 3). Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf (pika 4).

22. Në rastin konkret, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur të dënojë kërkuesin me 3 vjet burgim për kryerjen e veprës penale për të cilën ai akuzohej, duke mbajtur parasysh nenin 47 të KP-së. Ajo gjykatë ka arsyetuar mbi kufijtë e dënimit të veprës penale (1-4 vjet burgim), mbi rrezikshmërinë e veprës penale, mbi rrezikshmërinë e kërkuesit, duke e vlerësuar person të parrezikshëm, pasi nuk rezultonte që të ishte dënuar ndonjëherë më parë dhe mbi rrethanat lehtësuese sipas nenit 49 të KP-së, duke mbajtur parasysh faktin se ai rezultonte i padënuar më parë, moshën rreth 70 vjeç, gjendjen e rënduar shëndetësore, personalitetin e tij, faktin se kishte ushtruar një sërë funksionesh publike (drejtues i Prokurorisë së Apelit Tiranë në vitet 1997-2005, anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe i Këshillit të Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë në vitet 2001-2005), ndërsa ka çmuar se gjatë gjykimit nuk ka rezultuar ndonjë rrethanë rënduese (*shih vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, faqe 95 dhe 96*).

23. Për sa u përket rrethanave të parashikuara nga neni 59 i KP-së, ashtu siç u evidentua edhe më lart, Kolegji vëren se gjykatat kanë arsyetuar rreth aplikimit të asaj dispozite në rastin e kërkuesit. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se në rastin konkret plotësohen kushtet e parashikuara nga dispozita për të aplikuar këtë dënim alternativ, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur për kërkuesin dhe vënien e tij në provë. Konkretisht, sipas saj, kërkuesi është dënuar përfundimisht me 3 vjet burgim dhe gjykata ka mbajtur parasysh faktin se ai paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore (i padënuar më parë), moshën e tij (rreth 70 vjeç), gjendjen e rënduar shëndetësore sipas epikrizës të datës 07.11.2022 të lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", faktin se e ka vuajtur një pjesë të dënimit të tij me paraburgim sipas vendimit nr. 92, datë 05.09.2020 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Të gjitha këto rrethana i kanë krijuar bindjen gjykatës se ekzekutimi i vendimit me burgim dhe izolimi i mëtejshëm nga shoqëria nuk ishin të domosdoshëm ndaj kërkuesit. Lidhur me afatin e provës, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të nenit 59 të KP-së, ai afat është 24 muaj deri në 5 vjet dhe se në rastin konkret, duke mbajtur parasysh faktin se nga gjykata u arrit në përfundimin që kërkuesi të dënohet me 3 vjet

burgim dhe ky dënim të pezullohet, çmohet se ai duhet të vendoset në provë për një periudhë prej 3 vjetësh, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale (*shih vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, faqe 96-99*). GJKKO-ja e Apelit ka marrë në analizë pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për to. Konkretisht, sipas saj, kërkuesi është dënuar me 3 vjet burgim dhe sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 59 të KP-së në lidhje me pikën 3 të atij neni, për dënimet mbi 2 vjet burgim afati i provës është 24 muaj deri në pesë vjet burgim. Për rrjedhojë, GJKKO-ja e Apelit ka çmuar se disponimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë për vënien në provë të kërkuesit për një periudhë kohe prej 3 vjetësh, është në përputhje me parashikimet ligjore. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë u ka kushtuar kujdes të veçantë rrethanave në individualizimin e dënimit, veçanërisht atyre që lidhen me rrezikshmërinë e secilit prej të pandehurve, duke u ndaluar te gjendja sociale, profesioni, arsimimi, gjendja familjare dhe ajo gjyqësore, të pranuara nga praktika gjyqësore si elemente orientuese për t'u mbajtur parasysh për sa i përket rrezikshmërisë shoqërore të autorit (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqe 120*). Për këtë pretendim të ngritur edhe në rekurs, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ai ka marrë përgjigje shteruese dhe të argumentuar në prova dhe ligj në vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, me të cilën ajo gjykatë ka arsyetuar se ndan të njëjtin qëndrim (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafi 29*).

24. Për sa më sipër, Kolegji vëren se në aplikimin e alternativës së dënimit me burgim, gjykatat kanë marrë në analizë rrethanat e parashikuara nga neni 59 i KP-së dhe afatin e pezullimit të dënimit me burgim. Nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore për këtë pjesë, Kolegji vëren se ato gjykata kanë zbatuar dispozitën sipas kuptimit literal që ajo kishte në kohën e caktimit të kësaj mase, duke e arsyetuar atë. Në këtë drejtim, nuk rezulton që gjykatat të kenë dhënë për kërkuesin një afat më të gjatë pezullimi nga sa parashikon ligji, pasi koha e mbajtjes së kontaktit me shërbimin e provës llogaritet mbi bazën e masës finale të dënimit (në këtë rast 3 vjet) dhe jo mbi masën e dënimit që kishte mbetur pa vuajtur për kërkuesin, bazuar në llogaritjen e afateve të paraburgimit. Në këtë kuptim, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuesi, zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për sa i përket afatit të pezullimit të dënimit me burgim, nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bjerë në kundërshtim me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Për më tepër, Kolegji çmon se aplikimi i një alternative ndaj dënimit me burgim është një situatë favorizuese në raport me dënimin me burgim dhe se, në kuptim të nenit 59 të KP-së, ai nuk është i detyrueshëm për zbatim nga gjykatat e zakonshme, por është në diskrecionin e plotë të tyre. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se

pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të proporcionalitetit të dënimit mbështetur në këto argumente është haptazi i pabazuar.

25. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, për cenimin e së *drejtës për mbrojtje efektive të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit, parimit të prezumimit të pafajësisë* dhe *dinjitetit njerëzor*, kërkuesi ka parashtruar se gjykatat e faktit nuk kanë dhënë arsye të mirargumentuara për refuzimin për të marrë provat e kërkuesit, se organi i akuzës duhet të mblidhte jo vetëm prova që provonin fajësinë e të pandehurit, por edhe prova që shkonin në favor të tij dhe se në këtë kuptim disa elemente nga përgjimet e bisedave telefonike me të pandehurit N.B. dhe K.Zh., që shkonin në favor të kërkuesit, nuk janë vlerësuar nga gjykatat që kanë paragjykuar fajësinë e tij, në funksion të marrëveshjes së fshehtë të prokurorisë me avokatin P.F. Këto shkelje nuk janë korrigjuar as nga Gjykata e Lartë, e cila ka dalë me një vendim alogjik me arsyetim të pamjaftueshëm. Si rrjedhojë e të gjithë procesit është cenuar edhe dinjiteti i tij.

26. Gjykata ka pohuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, vlerësohet që të shqyrtojë të lidhura së bashku pretendimet e mësipërme të kërkuesit.

27. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar rëndësia që ka respektimi i parimeve të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit veçanërisht në gjykimin penal, pasi lidhen ngushtë me mbrojtjen e të pandehurit dhe përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme të procesit të rregullt ligjor. Këto parime presupozojnë që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Ndërsa në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, neni 30 i Kushtetutës parashikon se kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata ka theksuar se ky parim ka kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arritur në përfundimin se të pandehurit, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, e kanë konsumuar veprën penale për të cilën janë akuzuar, nga ana objektive nëpërmjet propozimit fillimisht dhe më pas dhënies së një përfitimi të paligjshëm në shumën 6.000 euro të pandehurës M.M. dhe bashkëshortit të saj të pandehurit A.C., me qëllimin që ajo, për shkak të funksionit të saj si gjyqtare, të ndikonte në zbutjen e masë së sigurimit personal që ishte caktuar ndaj shtetasit O.B. (vëllai i të pandehurit N.B.). Sipas saj, fakti rezulton i provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm me anën e provave të administruara gjatë gjykimit, si provat shkresore, provat me dëshmitarë, deklarimet e të pandehurve, dëgjimi i përgjimeve telefonike të regjistruara, si dhe këqyrja e pamjeve filmike të dokumentuara nga vëzhgimet e fshehta ambientale, të cilat gjejnë pasqyrim dhe shpjegim në mënyrë të hollësishme në këtë vendim në pjesën "rrethanat e faktit dhe burimet e provave" dhe se nuk ka asnjë rrethanë që të krijojë dyshime për autorët ose cilësimin juridik të veprës.

30. Pretendimet e kërkuesit se ishte konsultuar me avokaten e palës tjetër për qëndrimin e zëvendësimit të masës së sigurimit, sipas asaj gjykate, bien poshtë nga vetë deklarimet e tij, kur sqaron se avokaten e palës tjetër e ka takuar në datën 29.07.2020, ditën e gjyqit, dhe ka biseduar me të në lidhje me garancinë, ndërkohë që nga vëzhgimet në terren ka rezultuar se takimet që ka kryer në funksion të personit që mbronte si avokat, para orës së zhvillimit të gjykimit, kanë qenë me të pandehurit A.C. dhe K.Zh. Përfitimi i paligjshëm nga interpretimi i të gjitha provave në përputhje me njëra-tjetrën, si dhe nga vetë deklarimet e palëve gjatë gjykimit, sipas saj, rezulton që të jenë dhënë pas përfundimit të gjyqit, ku takimi i të pandehurve M.M. dhe K.Zh. ka ndodhur rreth orës 18:00. Fakti që masa e sigurimit personal në ngarkim të shtetasit O.B. është zëvendësuar kundrejt dhënies së një përfitimi të parregullt të pandehurës M.M., ka rezultuar i provuar edhe me anën e bisedave telefonike të përgjuara mes të pandehurve me njëri-tjetrin dhe me familjarët e tyre, të cilët, për shkak të pamundësisë ekonomike për ta disponuar një shumë të tillë, janë vënë në lëvizje për ta gjetur atë hua tek të afërm të tjerë. Ndërsa, fakti se ndërmjetës ka qenë kërkuesi ka rezultuar i provuar nga vëzhgimet në terren (takimet midis tyre), procesverbalet e transkriptimit të përgjimeve telefonike, me anë të të cilave provohet se të pandehurit kanë bërë të gjitha përpjekjet që të gjejnë rrugë të ndryshme për të arritur tek gjyqtarët që do të gjykonin çështjen penale me objekt zbutjen e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit O.B., dhe nga deklarimet e bëra në seancë gjyqësore nga vetë i pandehuri N.B., i cili, ndër të tjera, ka thënë se rreth tre ditë më vonë pas kthimit nga Pogradeci ka shkuar te zyra dhe i ka dhënë kërkuesit paratë.

31. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, i pandehuri N.B. është munduar të shfrytëzojë edhe njohjet me shtetasin D.D., ku nëpërmjet njohjes së këtij të fundit me shtetasin A.G. ka pasur

pritshmëri, por që nuk rezulton që të jenë realizuar më pas. Po ashtu, nëpërmjet njohjes që shtetasi E.B. ka pasur me shtetasin S.F. ka shpresuar që lirimin e O.B. mund ta realizonte avokati P.F., duke e kontraktuar për ta zgjedhur si avokat, mirëpo edhe ai nuk ka pranuar dhe nuk ka rezultuar që të jetë implikuar ndonjëherë në ndonjë nismë ose bisedë.

32. Për sa i takon dënimit të kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka çmuar se ai i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur të tij dhe vënien në provë, pasi: i) ai është dënuar përfundimisht me 3 vjet burgim; ii) paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore, pasi rezulton i padënuar më parë; iii) ka një moshë të madhe (rreth 70 vjeç); iv) ka gjendje të rënduar shëndetësore; v) ka vuajtur një pjesë të dënimit të tij me paraburgim.

33. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit. Përkundër pretendimit të kërkuesit për mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ajo gjykatë ka çmuar se vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë i përmban elementet e domosdoshme të kërkuara nga ligji procedural penal për t'u konsideruar një vendim i vlefshëm. Gjykata e shkallës së parë, sipas saj, e ka krijuar bindjen duke iu referuar vetëm provave të marra sipas ritit të gjykimit të zakonshëm, nëpërmjet çmuarjes së provave në tërësi. Fakti që të pandehurit nuk bien dakord me çmuarjen e fakteve dhe provave nga ajo gjykatë dhe me konkluzionet e arritura prej saj si rrjedhojë e procesit të çmuarjes së tyre, nuk e bëjnë të paarsyetuar vendimin e asaj gjykate.

34. Pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në lidhje me të drejtën për t'u hetuar dhe gjykuar nga një prokurori dhe gjykatë e paanshme, duke e lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe me pretendimin për implikimin e avokatit P.F., ajo gjykatë e ka gjetur të pabazuar. Për këtë, ajo gjykatë ka arsyetuar se në të kundërt me sa pretendon kërkuesi, qëndrimi i prokurorisë ose disponimi i gjykatës mbi kërkesat e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit apo për dhënien e lejes nuk përbëjnë shkaqe njëanshmërie në kuptim të parashikimeve ligjore që lidhen me përjashtimin ose heqjen dorë të gjyqtarëve nga gjykimi i çështjes. Po kështu, avokatja e asociuar pranë zyrës ligjore "F." të avokatit P.F. nuk rezulton të ketë qenë në asnjë prej rasteve të papajtueshmërisë për të vepruar si mbrojtës i të pandehurit N.B., në kuptim të parashikimeve ligjore të nenit 49/b të KPP-së, e që lidhen me qenien viktimë ose të afërm të saj sipas nenit 16 të atij kodi; person i thirrur si dëshmitar në të njëjtën çështje ose person i cili në të njëjtën çështje është ose ka qenë i bashkëpandehur, gjyqtar ose prokuror. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuesit për ekzistencën e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë dhe avokatit P.F. janë gjendur të pabazuara në prova.

35. Pretendimin e kërkuesit se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka lejuar si provë rezultatet e përgjimeve të komunikimeve telefonike të kryera në kuadër të një tjetër procedimi penal, duke pretenduar paligjshmërinë e tyre, GJKKO-ja e Apelit e ka gjetur të pabazuar në ligj, pasi shkaqet e pretenduara për pavlefshmërinë e procesverbalit nuk parashikohen nga nenet 128 e vijues të KPP-së si raste të pavlefshmërisë të akteve procedurale. Në kuptim të pikës 3 të nenit 151 të po atij kodi, duke vlerësuar se përgjimet nuk janë marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji (nenet 221 e vijues i KPP-së), ajo gjykatë i ka vlerësuar ato të përdorshme, pasi nuk ka konstatuar asnjë element paligjshmërie të mënyrës së përftimit të përgjimeve të komunikimeve telefonike dhe ambientale të kryera në kuadër të këtij procedimi penal, si dhe të atyre të përftuara në kuadër të procedimit penal nr. 185 të vitit 2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (*procedimi penal nr. 185/2020*). Ajo gjykatë ka evidentuar se përgjimet telefonike të kryera në kuadër të procedimit penal nr.185/2020 nuk mundet të konsiderohen tipike të këtij procedimi, por si akte të huazuara nga një procedim penal tjetër do të duhen të konsiderohen si prova atipike për nga mënyra sesi janë formësuar. Përgjimet e komunikimeve telefonike të kryera në kuadër të procedimit tjetër penal janë formësuar në përputhje me parashikimet ligjore të neneve 221-226 të KPP-së, dhe si të tilla, në kuptim të përcaktimeve të nenit 226, pika 1, të atij kodi, ato mund të përdoren si provë në këtë gjykim, duke konkluduar se procesverbalet e transkriptimit të përgjimeve të përftuara në kuadër të procedimit penal nr.185/2020 dhe ato në kuadër të procedimit objekt të këtij gjykimi do të kenë përdorshmëri të pakushtëzuar.

36. Në këtë drejtim, kërkuesi ka pasur kundërshtime lidhur me vërtetësinë ose me saktësinë e përputhjes të të dhënave të pasqyruara në procesverbalet e transkriptimit të përgjimit të bisedave telefonike dhe atyre pasqyruara në raportet e vëzhgimit ambiental, të kryera në kuadër të këtij procedimi penal. Referuar vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake është konstatuar nga GJKKO-ja e Apelit se mbi kërkesën e të pandehurve, përfshirë kërkuesin, për marrje të kopjeve të CD-ve të vëzhgimit, janë vënë në dispozicion të tyre dhe mbrojtësve të tyre të gjitha CD-të, të cilat nga policia i janë bashkëlidhur secilit procesverbal, ku janë dokumentuar veprimet e vëzhgimit. Po kështu, gjyqtari i seancës paraprake ka urdhëruar transkriptimin e përgjimeve të specifikuara prej të pandehurve. Nga ribërja e transkriptimeve është ndrequr edhe gabimi material i evidentuar në procesverbalin përkatës për transkriptimin e përgjimit të komunikimit të datës 28.07.2020, ora 20:17, ndërmjet kërkuesit dhe të pandehurit K.Zh., duke saktësuar momentet që kundërshtohen nga të pandehurit. Këto akte, sipas përmbajtjes së tyre, të konfirmuara në gjykimin në seancë paraprake dhe gjatë gjykimit në themel, janë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit, dhe mbi to është

bazuar GJKKO-ja e Shkallës së Parë në dhënien e vendimit. Kështu që pretendimet e të pandehurve për këtë pjesë janë gjetur të pabazuara.

37. Për pretendimet për themelin e çështjes, GJKKO-ja e Apelit ka analizuar të dhënat e rezultuara nga secila provë, duke mbajtur dhe qëndrimin e saj mbi vlerën dhe fuqinë provuese të secilës prej tyre në raport me shkaqet e ankimit të të pandehurve, përfshirë kërkuesin. Përgjimet e komunikimeve telefonike dhe ato ambientale, ekspertimet telefonike, si dhe vetë deklarimet e kërkuesit dhe të avokates E.B. tregojnë, sipas saj, në mënyrë të pakundërshtueshme se lirimi i shtetasit O.B. nuk është bërë duke i paguar shtetasit O.Xh. shumën 7.500 euro. Nga tërësia e përgjimeve të kryera në kuadër të këtij procedimi penal ka rezultuar se ndërmjet kërkuesit dhe kësaj avokateje ka pasur komunikime të vazhdueshme me fokus datën e gjykimit dhe trupin gjykues që do të gjykonte çështjen në Gjykatën e Apelit Korçë. Po kështu, në bisedat e përgjuara rezulton se kërkuesi dhe N.B. referojnë se pala tjetër, duke nënkuptuar personin që mbronte avokatja, kishte mbaruar punë duke i dhënë 7.500 euro gjyqtarit O.Xh., por se ato nuk japin asnjë të dhënë në drejtim të faktit që e njëjta skemë të ketë shërbyer edhe për lirimin e shtetasit O.B. Lirimi i këtij të fundit është realizuar sipas linjës së ndjekur nga të pandehurit në atë proces te gjyqtarja, me ndërmjetësimin e bashkëshortit të saj.

38. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit të ngritura në kuadër të parimit të prezumimit të pafajësisë, me argumentin se disa elemente nga përgjimet e bisedave telefonike që shkonin në favor të kërkuesit nuk janë vlerësuar nga gjykatat, GJKKO-ja e Apelit ka çmuar se këto pretendime, në thelb, kanë të bëjnë me mungesën e përgjegjësisë penale në kryerjen e veprës penale dhe në këtë drejtim GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke argumentuar themelësinë e akuzës së ngritur nga ana e prokurorisë, ka vlerësuar njëkohësisht edhe pathemelësinë e argumenteve ngritura nga ana e mbrojtjes për pafajësinë e të pandehurve në kryerjen e veprës penale sipas akuzave përkatëse (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqe 33*). Konkretisht, ajo ka evidentuar se në procesverbalin e pyetjes si person nën hetim kërkuesi ka deklaruar se N.B. i ka kërkuar të gjenin një mënyrë për të liruar vëllain, por përgjigjja e kërkuesit ka qenë se ka hyrë ta mbrojë si mik dhe se nuk është sekseri i tij. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se në të kundërt nga sa pretendon mbrojtja dhe kërkuesi për qëllimin e kërkimit të takimit (diskutimi i çështjes në aspektin profesional), qoftë edhe me një nga gjyqtarët që do të gjykonin çështjen në apel, të dhënat e analizuara tregonin që qëllimi i vërtetë të këtij takimi me një nga gjyqtarët ishte propozimi për dhënien e një vendimi në favor të shtetasit O.B. përkundrejt një përfitimi. Sipas asaj gjykate, në të gjitha bisedat e përgjuara ndërmjet N.B. dhe A.B. ose ndërmjet tyre dhe personave të tretë, si dhe në bisedat e zhvilluara ndërmjet këtyre shtetasve duket qartë se lirimi i shtetasit O.B. do të bëhej

përkundrejt dhënies së përfitimeve të parregullta gjyqtarëve që do të gjykonin çështjen e tij në Gjykatën e Apelit Korçë (*shih vendimin e GJKKO-së së Apelit, faqe 52-54*).

39. Bazuar në shkakun e ankimit të kërkuesit se vendimi për lirimin e shtetasit O.B. ishte i drejtë, sepse në rastin konkret nuk kishte vepër penale, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se nuk paraqet asnjë rëndësi për efekt të ekzistencës së veprës penale të korrupsionit aktiv, pasi vepra konsiderohet e kryer që nga çasti i premtimit ose i propozimit për një nga funksionarët e sistemit të drejtësisë si gjyqtarit, prokurorit ose punonjësit të organeve të drejtësisë, pavarësisht nga ardhja e pasojave të tjera.

40. Nisur nga kundërshtitë e kërkuesit për provat e kapura nga përgjimet, besueshmërinë, saktësinë dhe vlerën e tyre, komunikimet telefonike zanore ose me mesazh të të pandehurve, si dhe ndërmjet këtyre dhe personave të tjerë, si dhe përgjimet ambientale, janë vlerësuar si prova të besueshme nga ajo gjykatë, pasi janë marrë nëpërmjet një burimi të besueshëm/veprimit të përgjimit, i cili ka kaluar kontrollin gjyqësor, janë të sakta, sepse nuk kanë përkundrejt tyre prova të kundërta që të vënë në dyshim të dhënat e njoftuara prej tyre, kanë vlerë provuese, pasi janë marrë në përputhje me ligjin procedural, pa shkelur ndalimet e tij dhe po ashtu janë të rëndësishme/relevante në vërtetimin e fakteve objekt gjykimi. Fuqia provuese/pesha e provave të kapura nga përgjimet merr rëndësi në kushtet kur të dhënat e njoftuara prej tyre harmonizohen me provat e përftuara nga vëzhgimet ambientale, ato të përftuara nga pyetja e dëshmitarëve dhe të pandehurve gjatë gjykimit, si dhe me të dhënat e përftuara nga aktet e ekspertimit telefonik të aparateve celularë të pandehurve A.C. dhe K.Zh. Të afërmit e shtetasit O.B. (vëllai dhe nëna, si dhe persona të tjerë me të cilët këta të fundit kanë pasur komunikime) nuk kishin asnjë interes t'i thoshin njëri–tjetrit rrethana të pavërteta për pagesën e parregullt të kryer, pasi i shoqëronte vetëm interesi i përbashkët, lirimi i djalit/vëllait. Në këtë kontekst është pranuar se edhe në rastin kur komunikuesit flasin për persona të tretë, sikurse në rastin konkret, rezultati i përgjimit përbën burim prove me shumë rëndësi për sa kohë, referuar të dhënave dhe indicieve, nuk ngrihen dyshime të arsyeshme për të menduar që komunikuesit kanë qenë në përgjim ose dhe po sajonin situata për përfshirjen e personave të tjerë në veprimtarinë e paligjshme dhe, nga ana tjetër, ka dhe indicie të tjera mbështetëse.

41. Për rekursin e kërkuesit Gjykata e Lartë ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në të janë marrë në shqyrtim nga GJKKO-ja e Apelit, duke marrë përgjigje shteruese në vendimmarrjen e asaj gjykate, me të cilën ajo gjykatë ka ndarë të njëjtin qëndrim, duke mos konstatuar asnjë shkelje të karakterit ligjor nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas asaj gjykate, nuk ka mbivlerësim po ometim në vlerësimin e provave nga ana e gjykatave të faktit, pasi janë analizuar

të gjitha provat e paraqitura nga palët, si dhe janë marrë në analizë pretendimet e ngritura prej tyre, përfshirë pretendimet thelbësore si në drejtim të ekzistencës së faktit penal, ashtu edhe cilësimit juridik që duhet t'i mbivendoset faktit të provuar në gjykim. Vlerësimi i ndryshëm që palët i bëjnë provave nuk do të thotë, sipas saj, që vendimmarrja e gjykatave është e paarsyetuar ose e gabuar. Duke qenë se mbrojtja ka marrë përgjigje për akuzat e ngritura, vendimmarrja e gjykatës së apelit është e arsyetuar dhe nuk ka shkaqe që e bëjnë të cenueshme (*shih vendimin e Gjykatës së Lartë, paragrafi 31*).

42. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji vlerëson se gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë e kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk duket të kenë zhvendosur barrën e provës të kërkuesit dhe të kenë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprës penal të korrupsionit aktiv të gjyqtarëve, duke analizuar për këtë qëllim përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjërës prej tyre vlerë të paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit përtej dyshimeve të arsyeshme, duke arsyetuar se nuk ka asnjë rrethanë që të krijojë dyshime për autorët ose cilësimin juridik të veprës, bazuar në një sërë provash, si përgjimet e komunikimeve telefonike dhe ato ambientale, ekspertimet telefonike, si dhe deklarimet e personave që kishin dijeni për veprën penale, nga përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar atij lidhur me garancitë ligjore procedurale për vlerësimin e provave. Po kështu, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë vendosur për rrethin e provave që duhet të pranoheshin për shqyrtim, në përputhje me kompetencat e tyre. Ato i kanë dhënë përgjigje të detajuar çdo pretendimi të kërkuesit mbi kundërshtimet që ka pasur në procesin gjyqësor në ngarkim të tij. Ndërsa, Gjykata e Lartë e ka gjetur të drejtë qëndrimin e mbajtur nga GJKKO-ja e Apelit, duke u dhënë përgjigje në thelb edhe pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë.

43. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, konstatohet se në pjesën hyrëse ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, përmban shkaqet e ngritura në rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe në pjesën arsyetuese shkakun se përse rekursi nuk duhej të pranohej, konkretisht vlerësimin e Kolegjit Penal të saj, në vështrim të nenit 432 të KPP-së, për natyrën e këtyre shkaqeve. Ndonëse me arsyetim të kufizuar, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të mos ketë respektuar kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv. Përkundër asaj që pretendon kërkuesi, vendimet e gjykatave të posaçme janë marrë unanimisht dhe nuk ka mendime

pakice, ndaj Gjykata e Lartë nuk kishte si të arsyetonte për këtë. Për rrjedhojë Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara.

44. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.